



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr. 610/5 Prot.

Tiranë, më 16/6 /2014

REKOMANDIM

Nr 57, datë 16/6/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit Bashkia Korçë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 60 datë 11/04/2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer kontrolli administrativ pranë kontrolluesit Bashkia Korçë me objekt: "Zbatimi nga ana e kontrolluesit Bashkia Korçë e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij në fushën e veprimtarisë si institucion qendror në nivel vendor"

Bashkia Korçë, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është kontrollues publik, organ i qeverisjes vendore, i cili funksionon bazuar në ligjin nr. 8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", aktet nënligjore, rregulloret, urdhrat dhe udhëzimet për funksionimin e qeverisjes vendore. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbledh, përpunon dhe ruan të dhënave personale të qytetareve dhe të punonjësve kryesisht në rrugë manuale, si dhe nëpërmjet sistemeve e programeve elektronike.

Punonjësit tuaj kanë dijeni të pakta për ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" të ndryshuar dhe Autoritetin e Komisionerit, prandaj është e nevojshme që nga ana juaj të ndërmerren aktivitete dhe nisma të ndryshme për informimin dhe sensibilizimin e punonjësve lidhur me rëndësinë që ka mbrojtja e të drejtave të qytetareve për të dhënat personale dhe privatësisë të tyre. Aktiviteti që u realizua nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Bashkinë Korçë i shërbeu sensibilizimit jo vetëm të punonjësve tuaj por edhe të kontrolluesve tjerë të rëndësishëm në qytetin e Korçës dhe në këtë rast ju shprehim falënderimet tona për bashkëpunimin e shkëlqyer për organizimin e këtij aktiviteti, i cili me siguri do të shoqërohet edhe me nisma të tjera në mënyrë që publiku dhe kontrolluesit të njohin dhe të kërkojnë respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe respektimit të privatësisë.

Nga ana juaj është plotësuar gabim formulari i njoftimit në rubrikat 2.1 "fusha e veprimtarisë", 3.1 "kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen", nuk është zëvendësuar personi i kontaktit i cili ka ndërprerë marrëdhënien e punës, nga ju kërkohet plotësimi i saktë i këtij formulari dhe caktimi i personit të kontaktit në zbatim të kërkesave të neneve 21 e vazhdim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të

*Dhënave Personale*” i ndryshuar. Caktimi i një oficeri (*ose personi të ngarkuar*) i cili të jetë aktiv në punën e tij (*mundësisht jurist ose specialist IT*) lidhur mbrojtjen e të dhënave personale, shton besimin dhe transparencën e procesit të përpunimit të të dhënave personale në institucionin tuaj.

Në një pjesë të kompjuterëve që përdoren nga punonjësit mungon mbrojtja me fjalëkalim, program antivirus dhe sistem operativ i licencuar, nuk janë hartuar rregulla lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, prandaj në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, duhet të merrni masa dhe të hartoni rregullore të brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Hartimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga Institucioni juaj në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale i parashikuar në nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, nuk është realizuar. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe një mënyrë shumë efikase është informimi i subjekteve të të dhënave personale në formularët e ndryshëm, aplikimet on line, si dhe në faqen tuaj [www.bashkiakorçe.gov.al](http://www.bashkiakorçe.gov.al) në një rubrikë të veçantë të emëruar “*politikat e privatësisë*” (*paketë rregullash*).

Në këtë informim duhet të përfshihen mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtja e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqes tuaj në internet duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

Në kontratat e lidhura nga institucioni juaj me palë të treta, të cilëve u keni deleguar shërbime për llogari tuaj, nuk janë përfshirë rregulla mbi të drejtat dhe detyrimet që mbartin palët kontraktuese për garantimin e përdorimit të ligjshëm të sigurt dhe konfidencial të të dhënave personale, duke mos respektuar në këtë mënyrë nenin 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 19 datë 03/08/2012 “*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ligjshmëria, siguria dhe konfidencialiteti për përdorimin e të dhënave personale duhet të jetë gjithmonë nën vëzhgim dhe kontroll nga ana juaj, prandaj duhet që të bëhen ndryshimet e duhura në këto kontrata, ku të pasqyrohen detyrimet e palëve lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

## REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 21e vazhdim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, të plotësohen në formularin e njoftimit rubrikat 2.1 “*fusha e veprimtarisë*” dhe 3.1 “*kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”, si dhe të caktohet personi i kontaktit i cili të jetë mundësisht jurist ose specialist IT .

Informacione të rëndësishme lidhur me njoftimin mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë.

2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

Në faqet zyrtare në internet [www.bashkiakorçë.gov.al](http://www.bashkiakorçë.gov.al), të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë” (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t’i gjeni në Opininionin “Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat” publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al).

3. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

Në të gjitha kontratat e lidhura nga institucioni juaj me palë të treta, të cilëve u keni deleguar shërbime për llogari tuaj, të përfshihen rregulla mbi të drejtat dhe detyrimet që mbartin palët kontraktuese për garantimin e përdorimit të ligjshëm të sigurt dhe konfidencial të të dhënave personale.

4. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të merren masa për sigurinë e të dhënave personale, si dhe të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë.

5. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

6. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

